

**MBRETI ZOG DHE FAN NOLI
NË DOSJET E SIGURIMIT TË SHTETIT**

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
Instituti i Historisë

**MBRETI ZOG DHE FAN NOLI
NË DOSJET E SIGURIMIT TË SHTETIT**

Përgatiti: Hasan BELLO

Tiranë, 2021

Përgatiti: Hasan BELLO

Recensent: Akademik Beqir META

Radhiti: Ornela HAKA

Faqosja dhe kopertina: Dorina MUKA

© Copyright: ASA dhe autori

ISBN 978-9928-289-71-1

Botimet albanologjike

PARATHËNIE

“Mbreti Zog dhe Fan Noli në dosjet e Sigurimit të Shtetit” është një përmbledhje dokumentare ku përfshihen materiale nga tre dosje lidhur me këto personalitete të historisë dhe politikës shqiptare. Këto materiale janë tërhequr nga Autoriteti për Informim të Dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit (*AIDSSH*) pas deklasifikimit të tyre në përputhje me ligjin, duke u bërë objekt studimi për lexuesit dhe historianët.

Në dosjen Nr.1/1 të ish Mbretit Zog ndodhen dokumente të mbas Luftës së Dytë Botërore dhe një sasi artikujsh nga gazeta e revista të ndryshme mbi veprimtarinë e tij politike. Kjo dosje fillon nga data 20 tetor 1945 - 1 dhjetor 1951 dhe sipas inventarit përmban gjithsej 91 fletë.

Ajo hapet me një inventar të materialeve që ndodhen brenda saj, listën e operativëve që kishin në ngarkim këtë dosje (Ram Çelija dhe Mitro Zine) si dhe listën e personave që implikoheshin në këto materiale. Kjo ishte një procedurë standard e cila praktikohet në çdo dosje të Sigurimit të Shtetit.

Në këtë dosje gjenden informacione lidhur me veprimtarinë e Mbretit dhe të emigracionit politik; përpjekjet e tij e të drejtuesve të grupeve të ndryshme në kushtet tepër të vështira në të cilat ndodheshin si dhe organizimit të tyre kundër regjimit komunist.

Dosja hapet me një informacion të dërguar nga Londra lidhur me Familjen Mbretërore dhe oficerët që jetonin me Mbretin si dhe me qëndrimin parimor që ai mbante, duke lobuar në favor të pjesmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e San Franciskos. Kjo Konferencë u thirr nga SHBA-ja për të gjithë ato shtete që i kishin shpallur luftë Gjermanisë naziste deri në mars të vitit 1944. Pavarësisht armiqsisë që kishte me qeverinë komuniste, pjesmarrja e Shqipërisë në këtë Konferencë kishte një rëndësi të madhe për Mbretin. Sipas tij, kjo do të thoshte njohje e luftës së popullit shqiptar kundër nazifashizmit, që kishte nisur që me 7 prill 1939 me qëndresën e organizuar prej tij dhe të realizuar nga Abaz Kupi, Mujo Ulqinaku dhe oficerë të tjerë të shtetit shqiptar.

Me interes është pasqyrimi i mbërritjes së Mbretit Zog në Egjipt dhe përpjekjet e tij për të krijuar Komitetin “Shqipëria e Vërtetë”, i cili kishte si qëllim të bashkonte Shqipërinë me Kosovën; të punonte kundër “Federatës Ballkanike”, për të ndaluar influencën jugosllave mbi Shqipërinë etj.

Në vijim të qëndrimit të tij konsequent lidhur me mbrojtjen e interesave kombëtare, Mbreti do të kundërshtonte propozimin e bërë nga ana e britanikëve, që kundrejt dhënies së Korçës dhe Gjirokastrës grekëve, Shqipëria të merrte si “shpërblim” Kosovën. Sipas dokumentacionit, ai u kishte deklaruar atyre se, Korça e Gjirokastra për Shqipërinë ishin si një djalë i vetëm, prandaj nuk mund ta pranonte këtë propozim. Për çështjen e ashtuquajtur të “Vorioepirit”, të ngritur disa herë nga Athina zyrtare në organizatat ndërkombëtare, Mbreti u kishte deklaruar diplomatëve të ndryshëm dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë se qëndronte përkrah kundërshtarit të tij politik, Enver Hoxhës. Kjo ishte diferenca e Mbretit Zog me establishmentin komunist. Për interesat madhore kombëtare, ai ishte i gatshëm të bashkëpunonte edhe me kundërshtarin më të egër politik, kurse drejtuesit e regjimit komunist, ishin intrasigjentë dhe as që mendonin për një bashkëpunim të tillë, por kultivonin armiqësinë ekstreme si mjet për të mbajtur me çdo kusht pushtetin.

Në dosjen Nr.1/2 të Mbretit ndodhen dokumente të periudhës nga 11 prill 1952 – 12 mars 1962. Edhe kjo dosje hapet me një inventar të materialeve që ndodheshin brenda saj, operativët që e kishin në ngarkim (Ram Çelija dhe Mitro Zine) si dhe listën e personave që implikoheshin në këto materiale.

Në këtë dosje ndodhen informacione dhe radiograme për veprimtarinë e Mbretit në dekadën e fundit të jetës së tij, e cila karakterizohet nga një intensitet zhvillimesh që lidhen kryesisht me përpjekjet për të organizuar emigracionin politik shqiptar. Një sfidë që vijoi edhe në këtë periudhë ishte sistemimi dhe tërheqja e personaliteteve kryesore të emigracionit nga kampet dhe shtetet ku ata kishin mbetur në kushte tepër të vështira ekonomike. Për arritjen e këtij objekti dhe për të gjetur mbështetje nga Liga Arabe, pas konsultimit me gjeneralin Clayton, Mbreti inkuadroi një pjesë të shqiptarëve në ushtrinë e kësaj Lige për të luftuar simbolikisht kundër Izraelit.

Në një deklaratë për një agjenci të huaj shtypi më 3 nëntor 1949, përplasjen sovjeto-jugosllave me shumë të drejtë ai e konsideronte si “zënkë familjare”. Me këtë, ai, kishte parasysh botën sllave dhe lidhjet e gjakut që popujt e këtyre shteteve kishin me njëri-tjetrin pavarësisht grindjeve të përkohshme. Ai shtonte se Shqipëria ishte “gjakosur nga një minoritet komunist”.

Por lëvizjet e Mbretit nuk mbikqyreshin vetëm nga Sigurimi i Shtetit dhe shërbimet e huaja. Ai vazhdimisht ishte në fokus të shtypit. Kështu, në kohën kur Zogu u largua për në SHBA gazeta greke “Kathimerini”, duke folur për vajtjen e tij atje, shkruante se *“Ahmet Zogu mund të jetë ftuar nga «Komiteti Shqipëria e Lirë» për t'i pajtuar mbasi egzistojnë pikpamje të kundërta. Flitet se Zogu do përpiqet të marrë kontakt me Shtëpinë e Bardhë, me ndërmjetësinë e disa senatorëve të njohur si Gjenerali Donovan”*.

Pas rrëzimit të Mbretit Faruk në Egjipt nga junta ushtarake prosovjetike, për Familjen Mbretërore shqiptare u krijuan rrethana të vështira. Banesa e saj u mësy nga forcat ushtarake dhe pasuria iu konfiskua me pretekste të ndryshme. Falsiteti i tyre bëri që brenda një kohe të shkurtër, gjykata t'ua rikthente sendet e konfiskuara. Kjo ishte një formë presioni e nxitur nga shërbimet sekrete komuniste (me shumë gjasë KGB). Këto veprime ndiqeshin me kujdes nga amerikanët, të cilët bënë përpjekje për ta lejuar Mbretin që të largohej drejt Qipros, nga ku në bashkëpunim me të, të drejtonin aktivitetin e emigracionit politik shqiptar kundër regjimit komunist.

Por a ka patur tentativa për eleminimin fizik të Mbretit? Sigurisht që po. Kjo konfirmohet dhe nga dokumentacioni. Kështu, në një rast agjenti “Agimi” raporton nga Parisi më 13 shtator 1955 se një bashkëpunor me emrin Ferit Dajaka kishte biseduar me “Algjerianin” për të vrarë Mbretin Zog. Mbas dy tre ditësh, ai i kërkoi “Agimit” një automatik për të kryer vrasjen.

Nga dokumentacioni nuk del qartë nëse “Algjeriani” ishte pseudonim i ndonjë vrasësi me pagesë apo dikush tjetër... Më 24 shtator 1955 qendra i drejtoi një radiogram “Agimit”, ku e njoftonte se Ferit Dajaka, nuk ishte i përshtatshëm për të vepruar. Por regjimi komunist nuk hoqi dorë nga ky skenar. Përkundrazi, po në të njëjtën datë, me anën e një radiogrami tjetër, qendra kërkoi nga “Agimi” të mësonte se tek cili mjek do të vizitohej “Macukulli” (Mbreti Zog) dhe të studiohej mundësia që ta eleminonin fizikisht.

Tiranës zyrtare nuk i interesonte të bënte bujë nëpërmjet atentateve me armë. Asaj i leverdiste të përdorte metoda më të sofistikuar, të cilat gjithësesi nuk ndryshonin asgjë nga praktikat terroriste. Kjo vihet re nga relacioni i rezidenturës së Sigurimit të Shtetit që vepronte në kuadër të përfaqësisë shqiptare në Paris, e cila i raportonte qendrës: *“Në qoftë se arrijmë të rekrutojmë për agjent në shërbim të punës tonë ndonjë nga njerëzit besnikë që shoqërojnë Zogun do të marrim masa mbasi të kemi studiuar mundësitë për zhdukjen e Zogut. Në këtë studim do të parashikojmë helmimin e tij dhe të birit ose të krejt familjes, duke përdorur helmin në ushqim ose në pije.*

Nga ana tjetër, duke u informuar nga “Elmeta” së cilës do t'i ngarkohet për detyrë ose nga burime të tjera do të studiojmë doktorin që mjekon Zogun. Në këtë drejtim do të bëjmë studimin e rrethit të doktorit, qëndrimin e tij dhe të rrethit shoqëror e miqësor, për të mundur që nga një studim të gjithanshëm, të gjejmë elementin e përshtatshëm i cili, i udhëzuar nga ne, të organizojë zhdukjen e Zogut me anën e doktorit”.

Mjaftojnë këto fakte për të treguar implikimin e shërbimit sekret të Enver Hoxhës për të eliminuar kundërshtarët e tij jo vetëm brenda, por edhe jasht vendit. Helmimi i Familjes Mbretërore në një periudhë kur perdja e hekurt kishte garantuar pushtetin e stabilizimit komunist, tregon frikën, kompleksin, psikologjinë dhe mbi të gjitha karakterin terrorist të drejtuesve të PPSH-së dhe të Sigurimit të Shtetit, që nga krijimi i tyre në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

* * *

Në dosjen formulare Nr.1/3 gjenden dokumente në ngarkim të Fan Nolit. Edhe kjo dosje hapet me inventarin e materialeve, listën e personave që implikoheshin, listën e personave që ishin njohur me këtë dosje (Ram Çelija dhe Kleanthi Gjini) si dhe listën e atyre që e kishin në ngarkim (Ram Çelija dhe Servet Backa).

Kjo dosje fillon me informacione dhe materiale të grumbulluara për veprimtarinë e Fan Nolit që nga viti 1943 dhe mbaron në vitin 1964. Por ajo që të bën përshtypje është vendimi i Punëtorit Operativ Kleanthi Gjini për hapjen e dosjes formulare për Fan Nolin në vitin 1957. Pse ky vendim 13 vite pas vendosjes së regjimit komunist? Kjo kishte lidhje me thyrjen përfundimtare të raporteve të Nolit me këtë regjim. Të gjitha këto ndikuan që ai të vendosej në fokus të Sigurimit të Shtetit, pasi nuk konsiderohej më si mik. Kjo konfirmohet nga arsyetimi që bën Punëtori Operativ Kleanthi Gjini kur vendos të hapë këtë dosje. Sipas tij, pas çlirimit ai kishte mbajtur një qëndrim në favor të pushtetit popullor, ndërsa kohët e fundit ishte lëkundur dhe ishte bërë mbështetje për zbulimin amerikan. Madje, një nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, drejtuesi i gazetës “Dielli”, Qerim Panariti, nën udhëzimet e amerikanëve, shfrytëzonte faqet e kësaj gazete duke shkruar artikuj “me përmbajtje reaksionare, kundër qeverisë dhe regjimit komunist”. Ai theksonte se, për këto arsye, kishte vendosur të rihapte dosjen formulare për përpunimin e tij të rregullt. Kjo tregon se Noli nuk ishte hera e parë që gjendej në fokus të Sigurimit të Shtetit.

Në një biografi të përgatitur enkas për këtë dosje, e cila ishte për përdorim të brendshëm, pavarësisht raporteve formale që ekzistonin mes Nolit dhe regjimit komunist, artikullohet hapur pikëpamja që kishte Sigurimi

dhe drejtuesit më të lartë të shtetit duke e konsideruar atë si “*Politikan i vjetër dhe në shumë raste dallaveraxhi*”.

Një hipotezë që Sigurimi i Shtetit ngrinte rreth arsyeve të ftohjes së Nolit ndaj regjimit komunist ishin edhe letrat që ai merrte nga bashkëpunëtorë dhe miq të vjetër si Kostandin Boshnjaku dhe Kol Kuqali mbi zhvillimet e brendshme në Shqipëri. Për këto arsye, ai nuk konsiderohej më as simpantizant dhe as përkrahës i regjimit komunist, duke e vendosur kështu në radhën e armiqve.

Sigurimi i Shtetit e konsideronte si luhatjeje të Nolit një telegram që ai i kishte drejtuar Sekretarit të Shtetit për Politikën e Jashtme të SHBA-ve, Cordell Hull-it në vitin 1943. Në këtë telegram të botuar në gazetën “Dielli”- Noli vlerësonte qëndrimin e Turqisë dhe Egjiptit si dy vende myslimane, që nuk e kishin njohur pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste dhe vazhdonin të mbanin ende të hapura konsullatat e Mbretit Zog. Gjithashtu, ai kritikonte demokracitë perëndimore, të cilave u mungonte guximi duke njohur agresionin italian. Sipas tij, për aleatët do të ishte më e dobishme ta njihnin zyrtarisht Mbretin Zog dhe t’i jepnin rastin që të luante rolin e tij në fitoren e shumëpritur. Ashtu siç ia kishte theksuar edhe disa zyrtarëve në Washington, megjithë zhurmën e bërë prej disa kundërshtarëve, Zogu ishte i zoti për të punuar për aleatët anglo-amerikanë më tepër se cilido shqiptar ose grup shqiptarësh. Ai mendonte se ishte në interes të të dyja palëve (aleatëve dhe Shqipërisë), që zyrtarisht të kishte një qeveri shqiptare e kryesuar nga Mbreti Zog. Në këtë telegram, Noli kërkonte gjithashtu njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare të kryesuar nga Mbreti. Kjo do të ishte një garanci kundrejt deklaratave të bëra nga ministri i Jashtëm britanik Antoni Eden në Dhomën e Komunëve, që vinte në pikëpyetje kufijtë e shtetit të ardhshëm shqiptar pas lufte.

Në relacionet dhe biografitë informuese lidhur me qëndrimin politik të Nolit pas çlirimit, theksohet se ai “*ishte deklaruar botërisht pro nesh dhe se ka premtuar se do të vinte në Shqipëri*”. Por më vonë ishte tërhequr duke gjetur si pretekst se pengesat e nxjerra nga qeveria amerikane e kishin ndaluar të vizitonte Shqipërinë. Ai kishte vazhduar të fliste mirë për qeverinë komuniste të Enver Hoxhës, po jo në shtyp. Kjo për shkak se Noli i trembej masave që mund të mernin autoritetet amerikane, duke e konsideruar këtë si propagandë në favor të një qeverie që nuk kishte marrëdhënie diplomatike me SHBA-në.

Ajo që është për tu vlerësuar dhe që pasqyrohet edhe në dosjen e Sigurimit të Shtetit për Fan Nolin është lufta që ai bënte kundër influencës greke dhe priftërinjve të infiltruar prej saj për të marrë nën kontroll kishën ortodokse shqiptare në SHBA. Në këtë periudhë Noli ishte angazhuar për të

spastruar radhët e komisioneve kishtare nga të gjithë elementët “vriopiriotë” dhe filogrekë.

Sigurimi i Shtetit studioi me kujdes të gjitha mundësitë që Noli të bëhej një mbështetës i sigurtë i regjimit komunist. Sipas oficerëve që merreshin me përpunimin e kësaj figure, për realizimin e këtij plani nevojitej që Noli të mos sulmohej hapur për gabimet që ai kishte bërë në të kaluarën, jo vetëm nga qeveria e Enver Hoxhës, por edhe nga krerët e “Shqipërisë së Lirë” (organizatë kjo që ishte nën kontrollin e regjimit komunist); kisha ortodokse e Shqipërisë të vendoste korrespondencë zyrtare dhe të përpiquej që kishën shqiptare të SHBA-së ta merrte nën vartësinë e saj; meqenëse Noli ishte një historian dhe letrar të emërohej anëtar nderi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Kryesia e saj të vendoste korrespondencë të rregullt me të; një mjet tjetër ishte edhe mbështetja financiare.

Në këtë dosje ka informacione me vlerë rreth përpjekjeve të kishës greke dhe Patrikanës së Stambollit për të larguar Fan Nolin dhe për të caktuar si episkop të kishës shqiptare në SHBA priftin filogrek Marko Lipa; mbi përpjekjet e kolonisë shqiptare dhe të Fan Nolit për të kundërshtuar këto tentativa që do ta hidhnin në erë arritjet që ishin shënuar në fushën religjioze për më tepër se gjysëm shekulli.

Kundër propagandës së kishës ortodokse amerikane që nxitej nga grekët dhe mbështetësit e Marko Lipës, Noli botoi një shkrim brilant, në të cilin distancohej nga të gjitha akuzat e bëra si mbështetës i ideologjisë komuniste, që në thelb synonin kompromentimin e tij përpara autoriteteve zyrtare të SHBA-së. *“Unë nuk jam dhe nuk kam qenë kurrë anëtar i ndonjë organizate komuniste ose pro-komuniste. Nuk kam bërë kurrë në jetën t’ime ndonjë predikim komunist, prokomunist ose anti-amerikan. Përkundrazi, kam ekzaltuar gjithmonë demokracinë dhe mënyrën amerikane të jetesës dhe kam theksuar në mënyrë të veçantë faktin historik se Shqipëria ia dedikon independencën e saj në radhë të parë Amerikës dhe posaçërisht Presidentit Wilson. As kisha ime edhe as unë, nuk jemi nën juridiksionin e ndonjë Sinodi ose Patriarku të huaj, komunist ose tjetër, kështu që Kisha Ortodokse Shqiptare në Amerikë të cilën e kryesoj unë, është e pavarur administrativisht. Unë nuk kam pushuar kurrë ndonjë prift pse ka qenë anti-komunist. At Radoja e humbi pozitën e tij në New York për arsye se kërkoi nga Komiteti Lokal i Kishës që ose t’i paguajë një rrogë më të madhe ose të shikojë për ndonjë prift tjetër. Unë nuk kam sidoqoftë të bëj me emërime ose pushime peshkopësh ose kryepeshkopësh në kishën Ortodokse të Shqipërisë. Prandaj nuk jam përgjegjës në asnjë mënyrë për shkarkimin e kryepeshkopit Kissi dhe për emërimin e pasardhësit të tij, kryepeshkopit Vodica”.*

Në tetor të vitit 1956 Sigurimi i Shtetit krijoi bindjen se, pas qëndrimit kritik që mbante organi zyrtar i “Vatrës”, gazeta “Dielli” dhe

drejtuesi i saj Qerim Panariti kundër regjimit kumunist, qëndronte Fan Noli. Kjo përbën një fakt të rëndësishëm lidhur me trajtimin nga një këndvështrim i ri i raporteve të kësaj figure me qeverinë e Tiranës. Në rrethana tepër të vështira dhe në pleqëri të thellë, Noli ishte i detyruar që për hir të interesave kombëtare të bënte edhe ndonjë kompromis me diplomatët shqiptar në New York. Ai do u kërkoi atyre që Kisha Autoqefale Shqiptare, në bashkëpunim me qeverinë, të dërgonte në Amerikë një peshkop tjetër dhe dy priftërinj, sepse, ai ishte plak dhe pas vdekjes së tij kishte rrezik që kisha shqiptare atje të binte në duart e Marko Lipës, i cili ishte njeri i grekëve.

Nga ana tjetër, diplomatët dhe oficerët e shërbimit sekret shqiptar në New York ishin të vetëdijshëm për ndikimin e madh që Noli kishte tek kolonia shqiptare e Amerikës dhe, në pamundësi për ta shmangur, përpiqeshin ta shfrytëzonin në maksimum. Ata shkruanin se vizita e Nolit në Shqipëri do të kishte një efekt të madh politik. Prandaj ishin të mendimit që atij t'i dërgohej një ftesë nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve ose ndonjë institut tjetër shkencor.

Sigurimi i Shtetit ndiqte me kujdes grindjet dhe përplasjet brenda “Vatrës” dhe përpiqej t'i impononte asaj vijën e regjimit komunist. Me anën e agentëve të infiltruar jo vetëm Noli, por të gjithë drejtuesit kryesorë të saj, mbaheshin nën mbikëqyrje dhe bëheshin përpjekje që mes tyre të nxitej përçarja.

Hasan BELLO

PASQYRA E LËNDËS

1

Informacion mbi veprimtarinë e Mbretit Zog në Londër dhe politikën e tij për të mbështetur pjesmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e San Franciskos
Londër, më 20 tetor 1945 43

2

Informacin mbi lëvizjen e Mbretit Zog drejt Egjiptit dhe përpjekjet e tij për të krijuar Komitetin “Shqipëria e Vërtetë”, që kishte si qëllim bashkimin e shqiptarëve për rrëzimin e regjimit komunist dhe bashkimin e Shqipërisë me Kosovën
Egjipt, më 25 prill 1946 45

3

Informacion lidhur me këshillën që Mbreti Zog i kishte drejtuar shqiptarëve të Italisë për të mos lëvizur prej aty dhe kërkesën e Abaz Kupit për Xhemal Ferrën për të vendosur në dispozicion të Legalitetit 3.000.000 lireta
14 mars 1946 46

4

Informacion drejtuar Shkëlqesisë së Tij Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme mbi veprimtarinë e Mbretit Zog dhe të legalistëve në Egjipt
Kajro, më 31 dhjetor 1946 46

5

Letër e Kryetarit të Grupit të Legalitetit të Regio Emilia në Itali, Salih Muftija, drejtuar Mbretit Zog dhe për dijeni Kryetarit të Partisë së Legalitetit Abaz Kupi, lidhur me gjendjen e emigracionit politik shqiptar
Regio Emilia, më 5 qershor 1947 49

6

Informacion mbi emigrimin e detyruar të pjestarëve të Grupit të Legalitetit nga vendqëndrimi i tyre në kampet e Italisë
Romë, më 26 qershor 1947 53

- 7
 Informacion mbi bashkëpunimin e përfaqësuesve të Ballit Kombëtar dhe Bllokut Independent me Legalistët dhe Mbretin Zog
Kajro, më 8 janar 1948 54
- 8
 Informacion mbi takimin e Mbretit Zog me kryepeshkopin e Kishës Ortodokse në Aleksandri
Kajro, më 3 janar 1948 54
- 9
 Informacion drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, lidhur me artikullin e gazetës greke “FOS” me titull “Nga jeta në Aleksandri” e Mbretin Zog
Kajro, më 9 janar 1948 55
- 10
 Informacion mbi dërgimin nga ana Mbretit Zog të Abdyl Sulës në Amerikë i cili duhej të merrte kontakt me Fan Nolin dhe të Gaço Gogos në Francë
Kajro, më 16 janar 1948 56
- 11
 Informacion mbi takimet e Mbretit Zog dhe të bashkëpunëtorëve të tij me Sekretarin e Përgjithshëm të Ligës Arabe dhe shefin e Inteligjent Servisit britanik për Lindjen e Afërme për çështjen e refugjatëve politik shqiptarë dhe organizimin e tyre kundër regjimit komunist
Kajro, më 2 shkurt 1948 57
- 12
 Informacion mbi një darkë të shtruar nga ana Mbretit Zog për nder të Mehdi Frashërit, Xhafer Devës, Xhemal Mitrovicës dhe Hiqmet Delvinës të ardhur enkas nga Italia dhe përpjekjet për të krijuar një qeveri shqiptare në emigracion
Kajro, më shkurt 1948 57
- 13
 Informacion mbi formimin e Komitetit Qendror të Përkohshëm në Kajro me në krye Mbretin Zog dhe vendimet për krijimin e një fronti të përbashkët antikomunist si dhe të një qeverie shqiptare në ekzil
Kajro, mars 1948 58

- 14
Informacion mbi veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar dhe Mbretit Zog në Lindjen e Mesme për krijimin e një fronti të përbashkët antikomunist
Kajro, më 22 prill 1948 59
- 15
Informata mbi organizimin e Bashkësisë Shqiptare në Aleksandri dhe një darkë që shtrua me këtë rast, ku Mbreti Zog foli mbi vuajtjet e popullit shqiptar të shkaktuara nga sllavët dhe agjentët e tyre në Tiranë
Kajro, më 24 prill 1948 60
- 16
Informacion mbi veprimtarinë e Mustafa Krujës dhe bashkëpunimin e tij me Mbretin Zog
Kajro, më 4 maj 1948 61
- 17
Informacion mbi pakënaqësinë e bashkëpunimit të Ymer Fortuzit me Mbretin Zog
Kajro, më 4 maj 1948 61
- 18
Informacion mbi bashkëpunimin e Xhemil Dinos me Mbretin Zog dhe konsideratat e tij mbi Italinë si një shtet fqinjë që mund t'i ndihmonte për kthimin e tyre në Shqipëri
Kajro, më . maj 1948 62
- 19
Informacion mbi kontaktin e Xhemil Dinos me një funksionarë italian dhe bisedën me të lidhur me pikëpamjet e Mbretit Zog për Italinë
Romë, më .maj 1948 62
- 20
Informacion mbi vizitën e Mbretit Zog tek Patriku Kristorfor II dhe dekorimin nga ky i fundi të Gaqo Gogos
Romë, më .maj 1948 62
- 21
Informacion mbi vizitën e Ernest Koliqit në Siri dhe takimin e tij me kolonel Sterling, ish organizator i forcave të xhandarmërisë në periudhën e Mbretit Zog
Maj 1948 63

- 22
Informacion mbi emërimin e Neki Frashërit si sekretar të Mbretëreshës Geraldinë dhe mbi udhëtimet e saj në Itali dhe Zvicër
Romë, 1948 63
- 23
Informacion mbi veprimtarinë politike të Mbretit Zog për të organizuar një front antikomunist 63
- 24
Informacion mbi takimin e Mbretit Zog me një delegacion grek
New York, 1948 67
- 25
Informacion mbi përpjekjet e amerikanëve për organizimin e emigrantëve politik, për të cilën kishin atashuar pranë Mbretit Zog edhe një oficer me gradën e kapitenit
1948 67
- 26
Informacion mbi organizimin e emigracionit politik shqiptar në bashkëpunim me Mbretin Zog dhe përpjekjet e tyre për të krijuar një qeveri në ekzil
Kajro, 1948 67
- 27
Informacion mbi organizimin e emigracionit politik shqiptar rreth Mbretit Zog
Romë, më 2 qershor 1948 68
- 28
Informacion mbi aktivitetin e Mbretit Zog dhe takimet që ai kishte patur me ish organizatorin e xhandarmërisë shqiptare gjatë periudhës së Monarkisë gjeneral Sterling dhe patrikun ortodoks
Romë, më 22 qershor 1948 69
- 29
Informacion mbi një bashkëpunim mes zogistëve dhe përfaqësuesve të Bllokut Independent, si dhe mbi relatat e Mbretit Zog me Legatën italiane në Kajro, duke e konsideruar Italinë si të vetmin vend të madh që do të ndihmonte për rikthimin e shqiptarëve në atdhe
Romë, më 22 qershor 1948 69

- 30
Informacion mbi bisedimet e Xhemil Dinos me Mbretin Zog për bashkëpunimin e grupimeve të ndryshme politike të emigracionit shqiptar dhe deklaratën e tij se për çështjen e aneksimit të Korçës dhe Gjirokastrës nga Greqi qëndronte përkrah Enver Hoxhës
Romë, më 22 qershor 1948 70
- 31
Informacion për kthimin e Ymer Fortuzit nga Egjipti dhe pakënaqësia që ai kishte ndaj Mbretit Zog
Romë, më 24 qershor 1948 71
- 32
Informacion për organizimin e emigracionit politik shqiptar dhe bashkëpunimi i tyre me Mbretin Zog për të krijuar një front të përbashkët antikomunist
Romë, më 4 nëntor 1948 71
- 33
Informacion mbi takimin që Mbreti Zog kishte zhvilluar me drejtuesin e emigracionit politik jugosllav Grigoreviq
Kajro, më 24 nëntor 1948 72
- 34
Informacion mbi aktivitetin e Mbretit Zog dhe një takim që ai kishte zhvilluar me ambasadorin amerikan
Kajro, më 24 nëntor 1948 73
- 35
Informacion për organizimin e një kongresi nga emigracioni politik shqiptar dhe përpjekjet e Mbretit Zog për ta patur atë nën kontroll
Romë, më 15 mars 1948 73
- 36
Informacion mbi veprimtarinë e emigracionit politik dhe të Komitetit të Lëvizjes Patriotike Shqiptare si dhe raportet e tij me Mbretin Zog
Paris, më 27 dhjetor 1948 74
- 37
Informacion mbi dërgimin e një përfaqësuesi të Mbretit Zog në varrimin e Viktor Emanuelit dhe marrëdhëniet e tij me ministrin e Italisë në Egjipt
Kajro, më 8 janar 1949 75

38

Informacion mbi mbledhjen e kryesisë së Bllokut Independent dhe raportimin e Ernest Koliqit lidhur me misionin e tij në Egjipt dhe Siri ku kishte biseduar me Mbretin Zog për krijimin e një fronti të përbashkët antikomunist

Romë, më .shkurt 1949

75

39

Informacion mbi emigracionin politik shqiptar dhe financimine tyre nga qeveria egjiptiane, Mbreti Zog dhe nga pasaniku me origjinë shqiptare Mehmet Tahir Pasha

Kajro, më 24 mars 1949

77

40

Informacion mbi vizitën që Mbreti Zog zhvilloi së bashku me Musa Jukën dhe Sotir Martinin tek kryemyftiu i Egjiptit dhe rektori i Universitetit të Az`harit

Kajro, më 24 mars 1949

78

41

Informacion lidhur me refuzimin e Legatës Mbretnore në Egjipt për të pajisur me pasaporta disa emigrantë politikë që konsideroheshin si antizogistë

Paris, më 28 mars 1949

78

42

Informacion lidhur me përpjekjet e Mbretit Zog për të tërhequr dhe organizuar emigracionin politik shqiptar në Lindjen e Afërme si dhe takimin e planifikuar me mbretin Abdullah të Transjordanisë për t`i kërkuar ndihmë financiare për këtë qëllim

Kajro, më 24 prill 1949

79

43

Informacion lidhur me përpjekjet e Mbretit Zog për të siguruar mbështetje nga vendet e Ligës Arabe për emigracionin politik shqiptar

Kajro, më 24 prill 1949

80

44

Informacion lidhur me marrëdhëniet e Mbretit Zog me përfaqësuesit e shteteve perëndimore dhe të Ligës Arabe

Kajro, më 24 prill 1949

80

- 45
Informacion lidhur me formimin e një Komiteti nga Mbreti Zog dhe gjendjen dëshpëruese të emigracionit politik shqiptar
Paris, më 29 maj 1949 81
- 46
Pjesë nga procesi i Et`hem Çakos mbi veprimtarinë e zogistëve tek kolonitë shqiptare
Tiranë, më 31 korrik 1949 81
- 47
Biografia e Mbretit Zog e hartuar nga Sigurimi i Shtetit për punonjësit e tij
Tiranë, më 18 tetor 1949 82
- 48
Informacion lidhur me udhëtimin e Ymer Fortuzit drejt Aleksandrisë për të raportuar pranë Mbretit Zog pas takimit me Abaz Kupin
Kajro, më 18 tetor 1949 83
- 49
Informacion lidhur me veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar dhe Abaz Kupit për rikthimin në fron të Mbretit Zog
Kajro, më 26 tetor 1949 84
- 50
Informacion mbi vajtjen e Hasan Dostit në Kajro për tu takuar me Mbretin Zog si dhe kurorat me lule të vendosura nga ky i fundit dhe Departamenti Amerikan i Shtetit në varrin e Mid`hat Frashërit
Kajro, më 26 tetor 1949 85
- 51
Informacion lidhur me grupin e Seit Kryeziut dhe divergjencat e një pjese të emigracionit me Mbretin Zog
Kajro, më 31 tetor 1949 85
- 52
Informacion lidhur me grupin e Seit Kryeziut dhe agrarëve si dhe divergjencat e tyre me Mbretin Zog
Kajro, më 31 tetor 1949 86

- 53
 Informacion lidhur me një intervistë të Mbretit Zog për gazetën “Le Journal d’Egjipt”
Kajro, më 31 tetor 1949 86
- 54
 Informacion lidhur me emigracionin politik shqiptar dhe divergjencat që kishin përkrahësit e Mbretit Zog me grupin e Seit Kryeziut
Tiranë, më 3 nëntor 1949 87
- 55
 Informacion lidhur me një intervistë të Mbretit Zog për gazetën “Le Journal d’Egjipt”
Tiranë, më 5 nëntor 1949 87
- 56
 Informacion lidhur me vizitën e Mbretëreshës Geraldinë së bashku me të birin në Itali dhe kërkesën që disa personalitete shqiptare me influencë si Xhemil Dino e Rrok Stani duhej të bënin pranë autoriteteve italiane që asaj t’i bëhej një pritje gjysëm zyrtare
Romë, më 3 dhjetor 1949 88
- 57
 Informacion lidhur me vizitën e Mbretëreshës Geraldinë së bashku me të birin në Itali dhe kërkesën që disa personalitete shqiptare me influencë si Xhemil Dino e Rrok Stani duhej të bënin pranë autoriteteve italiane që asaj t’i bëhej një pritje gjysëm zyrtare
Romë, më 14 dhjetor 1949 89
- 58
 Informacion lidhur me një broshurë të hartuar nga legalisti Salih Myftia dhe dërgimi i atij në Amerikë
New York, më 19 dhjetor 1949 89
- 59
 Informacion lidhur me Komitetin Shqipëria e Lirë dhe kontradiktat e tyre
Tiranë, më 2 shkurt 1950 90
- 60
 Informacion mbi veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar dhe divergjencat e tyre
Tiranë, më 2 shkurt 1950 90

- 61
Informacion lidhur me një intervistë të Mbretit Zog të ribotuar nga shtypi francez
Tiranë, më 10 janar 1950 91
- 62
Përmbledhje e shkresës Nr. 914 të Degës së Punëve të Brendshme në Elbasan lidhur me familjen e bashkëshortes së Xhelal Zogut
Elbasan, më 9 nëntor 1950 91
- 63
Biografia e kunatit të Xhelal Zogut, Ferit Allajta
Elbasan, më 18 janar 1952 92
- 64
Biografia e vjehrrës së Xhelal Zogut, Ylkije Allaj
Elbasan, më 13 dhjetor 1950 93
- 65
Biografia e Fiqiri Zylfiut
Elbasan, më 13 dhjetor 1950 94
- 66
Informacion mbi nisjen e Ali Këlcyrës drejt Egjiptit për tu takuar me Koço Mukën dhe Mbretin Zog
Romë, më 5 korrik 1950 95
- 67
Informacion mbi një deklaratë të Mbretin Zog të botuar nga shtypi italian sipas të cilës ai i bënte thirrje shteteve të Perëndimit të ruanin integritetin tokësor të Shqipërisë
Romë, më 12 korrik 1951 95
- 68
Informacion lidhur me përpjekjet e Mbretit Zog për tu zhvendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe thashethemet për arsyet e këtij largimi
Romë, më 11 gusht 1951 96
- 69
Informacion lidhur me një artikull të gazetës greke “Kathimerini” mbi përpjekjet e Mbretit Zog për tu zhvendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për arsyet e këtij largimi
Romë, më 2 dhjetor 1951 97

- 70
Letër drejtuar Mbretit Zog nga “OSTER” (Amerika) mbi shkrimet e ekzagjeruara të shtypit amerikan lidhur me pasuritë e tij
New York, më 19 shtator 1951 97
- 71
Telegram drejtuar Mbretit Zog nga “OSTER” mbi shkrimet e ekzagjeruara të shtypit amerikan lidhur me pasuritë e tij
New York, më 19 shtator 1951 99
- 72
Informacion lidhur me kthimin e Mbretit Zog nga New Yorku në Egjipt dhe përpjekjet e tij për të tërhequr familjen dhe bashkëpunëtorët e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Romë, më 1 tetor 1951 100
- 73
Informacion lidhur me një letër që Kompania e Bizhuterive dhe Diamanteve Amerikane “OSTER” i dërgonte Mbretit Zog nga New Yorku
Egjipt, më 1 tetor 1951 101
- 74
Përmbledhje informatash që flasin për Ahmet Zogun nxjerrë nga procesi i Angjo Rulit
Tiranë, më 11 tetor 1952 101
- 75
Përmbledhje informatash që flasin për Ahmet Zogun nxjerrë nga procesi i Angjo Rulit
Tiranë, më 17 nëntor 1952 102
- 76
Radiogram drejtuar “Abruzit” në Romë për të mbledhur informacion lidhur me mbledhjen e organizuar nga Mbreti Zog me disa personalitete të emigracionit politik shqiptar dhe ambasadorin amerikan në Egjipt
Tiranë, 1952 102
- 77
Radiogram i agentit “Abrusio” në Romë drejtuar eprorit “Dajti” në Tiranë, lidhur me vajtjen e Abaz Kupit dhe Ali Këlcyrës në Greqi për të hetuar lidhur me grindjet që ekzistonin mes zogistëve dhe agrarëve
Romë, më 8 korrik 1952 103

78

Radiogram drejtuar “Besnikut” në Paris për të mbledhur informacion lidhur me mbledhjen e organizuar nga Mbreti Zog me disa personalitete të emigracionit politik shqiptar dhe ambasadorin amerikan në Egjipt

Tiranë, më 20 korrik 1952

104

79

Radiogram drejtuar “Abruzit” në Romë për të mbledhur informacion lidhur me vajtjen e Ali Këlcyrës në Egjipt dhe krijimin e një qeverie nga Mbreti Zog

Tiranë, më 30 korrik 1952

104

80

Radiogram i agjentit “Abrusio” në Romë drejtuar eprorit “Dajti” në Tiranë, lidhur me vajtjen e Mbretëreshës Geraldinë së bashku me princin në Itali ku priste të takohej dhe me Papën

Romë, më 3 shtator 1952

105

81

Radiogram i agjentit “Abrusio” në Romë drejtuar eprorit “Dajti” në Tiranë, lidhur me vajtjen e Mbretëreshës Geraldinë në Itali ku sipas të dhënave pritej të shkonte edhe Mbreti Zog

Romë, më 17 shtator 1952

105

82

Radiogram i agjentit “Besniku” në Paris drejtuar eprorit “Dajti” në Tiranë, lidhur me vajtjen e Mbretëreshës Geraldinë së bashku me princin në Paris ku pritej të shkonte edhe Mbreti Zog

Paris, më 17 shtator 1952

106

83

